



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:094358

Datë: 30.06.2022

Numri i dokumentit: 03189646

PKR. Nr. 88/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Krimeve të Rënda, me Kryetarin e trupit gjykues, gjyqtarin Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Alan Taranish, në çështjen penale kundër të akuzuarit J B nga Peja, për shkak të veprave penale, *“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”*, nga neni 366 par.1, dhe veprës penale, *“Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”*, nga neni 367 par. 1, të KPRK-së, dhe kundër të akuzuarit S B për shkak të veprës penale, *“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”*, nga neni 366 par.1, të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, **PP/I Nr. 125/2022**, të datës **10.05.2022**, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë **21.06.2022**, në prezencë të Prokurores se shtetit Lumturije Vuçetaj dhe të akuzuarve J B dhe S B, te njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. **30.06.2022**, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

J B, nga i ati R dhe e ëma R e gjinisë Th, i lindur me në fsh. A, K. D., tani me vendbanim në rr. nr. . në P., i identifikuar me numër personal , i martuar, baba i pese fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion elektrikist, i gjendjes se mesme ekonomike, posedon nr. të telefonit, shqiptar, shtetas i republikës së Kosovës, mbrohet në liri,

S B, nga i ati B dhe e ëma E, e gjinisë Gj, i lindur me dt., në K, me vendbanim në fsh. K, K. P., i identifikuar me numër personal te letërnjoftimit, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka te kryer shkollën fillore, i gjendjes jo të mire ekonomike, me profesion bujk, posedon nr. të telefonit, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri,

JANË FAJTOR

Për shkak se:

I pandehuri J B

I. Më parë dhe gjerë me datë 20.03.2022, rreth orës 11:20, në rr. ” M.A” nr., P., i pandehuri në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit Për Armë (Ligji Nr.05/L-022), ka mbajt në pronësi dhe kontroll të paautorizuar, dhe atë një pistoletë e llojit ‘Z., kalibër 7.62x25m, me nr. serik ...dhe një karikator, në atë mënyrë që, ditën kritike pasi që i njëjti ishte i ftuar në një aheng familjar fejesë tek A D, i pandehuri për një moment shkon në shtëpinë e tij, e cila gjendej rreth 300-400

metra larg vendit të ngjarjes dhe aty merr armën e lartcekur dhe kthehet në vendin ku po mbahej ahengu, ku për një moment e nxjerr pistoletën dhe me te njëjtën shtënë katër herë në ajër, me ç' rast me të marr informatën policia kanë shkuar dhe i kanë sekuestruar armën te cilën e kishte përdorë me të dhënat e sipërshënuara,

- me çka ka kryer veprën penale, ***“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”***, nga neni 366 par. 1, të KPRK-së.

II. Më datë 20.03.2022, rreth orës 11:20, në rr. ‘‘ G.K’’ në P., i pandehuri përdor armën e zjarrit - pistoletën e llojit Z., kalibër 7.62x25m dhe nr. serik ..., te cilën e kishte në posedim pa leje te organit kompetent, në atë mënyrë që, i pandehuri ditën kritike në ahengun familjar tek A D ku ishte mysafir, pasi qe merr armën në shtëpinë e tij, te njëjtën e përdorë duke shtënë me te katër herë në ajër, ku si pasojë e gjuajtjes policia me te marr informatën shkojnë në vendin e ngjarjes dhe identifikojnë te njëjtin dhe i sekuestrojnë armën me pjesët përcjellëse si dhe gëzhojat në vendin e ngjarjes,

- me çka ka kryer veprën penale, ***“Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”***, nga neni 367 par. 1, të KPRK-së.

I pandehuri Sejdi Berisha

III. Më parë dhe gjerë me datë 20.03.2022, në fshatin K., K.P. i pandehuri në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit Për Armë (Ligji Nr.05/L-022), ka mbajtur në pronësi dhe kontroll të paautorizuar, dhe atë një pistoletë te llojit ‘‘Z.’’, kalibër 9x19m dhe nr. serik ...me një karikator të zbrazët, në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri përderisa ishte në ahengun familjar tek A D, ku i pandehuri J B përdorë armën te cilën e kishte në posedim, me ç' rast me te arritur policia në vendin e ngjarjes dhe pas kërkesës se tyre se a ka edhe dikush tjetër armë, i pandehuri në fjalë përgjigjet duke e dorëzuar armën me te dhënat si me lart,

- me çka ka kryer veprën penale, ***“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”***, nga neni 366 par. 1, të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 7, 8 par. 1, 9, 10 par. 1, 17 par. 1, 21 par. 1 dhe 2, 38, 39, par. 1, nën par. 1.1, 40, 42, 43, 44, 69, 70, 71, 72, 76, dhe 366 par. 1, dhe par. 3, dhe 367 par. 1, të KPRK-së, dhe nenit 245, 246, 248 par. 1 dhe 4, 359, 360, 361, 365, 366, 450 par.1 dhe 2, te KPRK-së, të pandehurit J B i:

P ë r c a k t o n

- Për veprën penale nga dispozitivi I, aktakuzës/aktgjykimi dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muajve.
- Për veprën penale nga dispozitivi II , aktakuzës/aktgjykimi me dënim burgim në kohëzgjatje prej katër (katër) muajve.

Ne kuptim te nenit 76 par.1 dhe par.2 nën par 2.2 te KPRK-së, gjykata te pandehurit J B e:

G J Y K O N

Të pandehurin J B

1.Me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve burgim.

2.Me pëlqimin e të pandehurit J, e në përputhje me nenin 44 par.1,2, të KPK-së, dënimi i unifikuar sipas pikës 1, në kohëzgjatje prej prej gjashtë (6) muajve burgim, i është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumën prej një mijë (1.000) euro, e të cilin dënim i njëjti **Urdhërohet**, për ta paguar në afatë prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, pasi që ky aktgjykim ta merë formën e prerë.

Të pandehurin S B,

3.Me dënimin gjobë në shume prej katërqind (400) euro, e të cilin dënim i njëjti ka për ta paguar në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, pasi që ky aktgjykim ta merr formën e prerë.

4.Nëse të pandehurit J B dhe S B, dështojnë, refuzojnë apo nuk dëshirojnë ta paguajnë dënimet e shqiptuara me gjobë sipas pikave(2 i pandehuri J dhe sipas pikës 3 i pandehuri S) ,të këtij dispozitivi të aktgjykimit, të njëjtat dënime do t'iu zëvendësohen në dënim burgimi, duke i llogaritur shumën prej njëzetë (20) euro për një dit burgimi.

5.Obligohen të pandehurit secili veç e veç, që gjykatës, ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumë prej njëzetë (20) euro, dhe shumën prej pesëdhjetë (50) euro, ne emër te fondit për kompensimin e viktimave te krimit.

6.Në kuptim të nenit 366 par.3, të KPRK-së, ndaj të pandehurve J B dhe S B ju shqiptohet:

DËNIMI PLOTËSUES – MARRJA E SENDIT/KONFISKIMI

KONFISKOHET një pistoletë e llojit ‘Z., kalibër 7.62x25m, me nr. serik ...dhe një karikator, si dhe një pistoletë te llojit ‘Z.’, kalibër 9x19m dhe nr. serik ...me një karikator të zbrazët, si dhe gëzhhojat dhe te njëjtat **URDHËROHEN**, të shkatërrohen pasi qe Aktgjykimi të behët i plotfuqishëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën nën shenjen **PP/I. Nr. 125/2022** të datës **10.05.2022** kundër të akuzuarit J B nga Peja, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprat penale, “**Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve**”, nga neni 366 par.1, dhe veprës penale nga neni “**Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm**”, nga neni 367 par. 1, të KPRK-së dhe kundër të akuzuarit S B nga fsh. K, K. Pejë për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale “**Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve**”, nga neni 366 par.1, të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën kane qenë prezentë Prokurori i Shtetit dhe të pandehurit J B dhe S B.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit, nën shenjen **PP/L. Nr. 125/2022** të datës **10.05.2022**, në seancën e shqyrtimit fillestar, në prezencën e Prokurorit të Shtetit dhe të pandehurve J B dhe SB, gjykata është bindur se të akuzuarit e kanë kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarve ju ka dhënë mundësinë që të deklarohen për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata, ka udhëzuar të akuzuarit, për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë, dhe i akuzuari J B ka deklaruar se i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e fajësisë dhe në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije **e pranon fajësinë**, për veprat penale, **“Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve”**, nga neni 366 par.1, dhe veprës penale nga neni **“Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”**, nga neni 367 par. 1, të KPRK-së, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës pa asnjë ndryshim, i vjen keq për veprimin e bërë, dhe po ashtu i akuzuari S B ka deklaruar se i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e fajësisë dhe në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije **e pranon fajësinë**, për veprat penale, **“Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve”**, nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Prokurori i Shtetit në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë, meqenëse ka mbështetje në shkresat e lëndës dhe i propozoj gjykatës që këtë pranim të fajësisë ta aprovon.*

Në vijim, gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarve vlerësoi se pranimi i tyre i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarve, pasi që ata e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata me Aktvendim procedural, e ka aprovuar pranimin e fajësisë, për veprat që i vihen në barrë, nga ana e të akuzuarit ngase pranimi i fajësisë gjen mbështetje edhe në provat vijuese: *Raporti i policit N G i datës 20.03.2022; raporti informues i policit A K #... i datës 20.03.2022; procesverbali mbi marrjen në pyetje të dyshuarit J B të dhënë në polici me dt.20.03.2022 si dhe në prokurori me dt.05.05.2022; procesverbali mbi marrjen në pyetje të dyshuarin S B të dhënë në polici me dt.20.03.2022 si dhe në prokurori me dt.05.05.2022; lista e armëve të konfiskuara të datës 20.03.2022; fotografitë e armëve të realizuara nga policia, si dhe shkresat tjera të lëndës, dhe mbi këtë është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë, se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë dhe për këtë është vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 326 par. 4, të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 248 par. 4, të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.*

Prokurori i Shtetit në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese ka deklaruar se: *meqenëse të pandehurit secili veç e veç e pranuan fajësinë për veprat penale për të cilat janë akuzuar u vërtetua gjendja faktike si ne dispozitivat e aktakuzës, andaj propozoj gjykatës që të njëjtit të shpallen fajtor të dënohen sipas ligjit dhe të obligohen në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale, ndërsa me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin si rrethana lehtësuese ta merr pranimin e fajësisë, pendimin e tyre si dhe premtimin që nuk do ta kryejnë veprat penale në të ardhmen si dhe padenueshmerine e tyre e deritanishme, ndërsa si rrethana renduese shkallen e larte të dashjes.*

I pandehuri J B në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese ka deklaruar se: *i propozoj gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin të merr parasysh rrethanat lehtësuese*

të potencuara nga PSH, është hera e pare që bie ndesh me ligjin, i premtoj gjykatës së në të ardhmen nuk do ta përsëris veprimet e tilla, i propozoj gjykatës që të më shqiptojë një dënim me gjobë nëse ekziston mundësia ligjore pasi që planifikoj ta udhëtoj në boten e jashtme tek familja ime.

I pandehuri S B në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese ka deklaruar se: i propozoj gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin të merr parasysh rrethanat lehtësuese të potencuara nga PSH, është hera e pare që bie ndesh me ligjin, i premtoj gjykatës së në të ardhmen nuk do ta përsëris veprimet e tilla, i propozoj gjykatës që të më shqiptojë një dënim me gjobe pasi që planifikoj ta udhëtoj në boten e jashtme tek familja, aktualisht unë ndihmohem për çdo muaj nga motra dhe vëllai, pavarësisht gjendjes time e lus gjykatën që të më shqiptohet një dënim me gjobe nëse është mundësia dhe të jete sa me e arsyeshme, është i pa punë, aktualisht shifët që i njëjti ka pas një operim dhe sulm ne tru dhe shifët ne seance se i njëjti ka probleme shëndetësore.

Me faktet e ofruara ne shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv I, II dhe III të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit J B qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale **“Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve”** nga neni 366 par.1, dhe veprës penale **“Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”**, nga neni 367 par. 1, të KPRK-së, ndërsa në veprimet e të pandehurit S B qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale **“Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve”** nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se te i pandehuri J B, ka ekzistuar dashja që veprat penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv I dhe II të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprat e kryera dhe e ka dëshiruar kryerjen e tyre.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se te i pandehuri S B ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv III, të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale e të pandehurve, kështu që të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Kryetari i trupit gjykues në aplikim të neneve 69 dhe nenit 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe renduese të përcaktuara e të përmendura nga ana e Prokurorit të Shtetit gjatë seancës të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që për të pandehurin J B si rrethana lehtësuese gjeti se i pandehuri në shqyrtimin fillestar ka bërë pranimin e fajësisë në mënyrë të vullnetshme, po ashtu pendimin e tij për veprën e kryer, sjelljen e tij korrekte gjatë shqyrtimit, mosdenueshmerine e tij të mëparshme, ndërkaq nga rrethanat renduese gjykata në rastin konkret për të pandehurin J B gjeti shkallen e lartë të dashjes, ndërsa sa i përket të pandehurit S B, për të njëjtin si rrethana lehtësuese gjeti se i pandehuri në shqyrtimin fillestar ka bërë pranimin e fajësisë në mënyrë të vullnetshme, po ashtu pendimin e tij për veprën e kryer, sjelljen e tij korrekte gjatë shqyrtimit, mosdenueshmerine e tij të mëparshme, ndërkaq nga rrethanat renduese gjykata në rastin konkret për të pandehurin S B gjeti shkallen e lartë të dashjes.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë

penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KRPK-së.

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit për veprën penale, **“Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm”**, nga neni 367 par. 1, të KRPK-së, e për të cilën ka qenë i akuzuar i pandehuri J B, ka aplikuar dispozitat të cilat kanë të bëjnë me zbutjen e dënimit, e krejt kjo duke pasur parasysh rrethanat veçanërisht lehtësuese të cekura si më larte, ashtu që duke vepruar konform dispozitave ligjore të nenit 71 dhe 72 par. 1 nën par. 1.5, të KRPK-së, e ku përcaktohet se *“nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej një (1) viti, dënimi mund të zbutet deri në tre (3) muaj burgim”* ashtu që gjykata të njëjtit i ka shqiptuar dënimin me burgim ndër minimumit të parapare ligjor në aplikim të këtyre dispozitave dhe atë dënim me burgim në kohëzgjatje prej katër (4) muajve.

Gjykata të pandehurit J B për veprën penale i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 muajve konform nenit 366 par. 1, të KRPK-së.

Konform dispozitës ligjore të nenit 76 par. 1 dhe 2 nën par. 2.2 gjykata në raport me të pandehurin J B bëri unifikimin e dënimeve ashtu që të njëjtit i shqiptoi dënim të unifikuar në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve.

Gjykata po ashtu të pandehurit J B e konform dispozitës ligjore të nenit 44 par. 1, dhe 2, të KRPK-së, i ka dhënë mundësinë që dënimi me burgim i unifikuar për veprat që ngarkohet sipas pikave I, dhe II të aktakuzës/aktgjykimit, ti zëvendësohet me dënim me gjobë në shume prej një mijë (1000) euro, ashtu që i njëjti pas shpalljes së aktgjykimit burimor ka dhënë një pëlqim të tillë.

Vendimi për shqiptimin e dënimit me gjobë për veprën penale, **“Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”**, nga neni 366 par. 1, të KRPK-së në raport me të pandehurin S B, u morr konform nenit 43 par. 1, të KRPK-së.

Vendimi për zëvendësimin eventual e dënimeve të shqiptuara me gjobe me dënim burgimi në rast se të pandehurit dështojnë, refuzojnë apo nuk dëshirojnë ta paguajnë dënimet e shqiptuara me gjobë u morr konform nenit 43 par. 3, të KRPK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u morr në bazë të nenit 453 par.1, lidhur me nenin 450 par.1 dhe 2 pika 2.6, të KPPRK-së.

Vendimi për taksat e kompensimit të viktimave të krimit, u morr në bazë të qarkores për zbatimin e ligjit NR.05/L-36.

Vendimi për konfiskimin e armeve dhe municionit, u morr konform nenit 366 par. 3, të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr.88/22 dt. 30.06.2022

Zyrtari ligjor,
Alan Taranish

Kryetari i trupit gjykues,
Dr.sc. Murat Hulaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.